

**CONTAINPORARY KURATOR/ EKSPOZUES MAKSUT VEZGISHI
PAVILIONI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS**


**ORGANIZATORË MINISTRIA E KULTURËS, RINISË
DHE SPORTIT, REPUBLIKËS SË KOSOVËS/ VENDI ARSENALE
HAPJA 22 MAJ–21 NËNTOR, 2021
KOSOVOPAVILION17TH.COM**



La Biennale di Venezia

**17. Mostra
Internazionale
di Architettura**

Partecipazioni Nazionali



CONTAINPORARY KURATOR/ EKSPUZUES MAKSUT VEZGISHI PAVILIONI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

TOKA ËSHTË SHTËPI/ ROLI I URBANIZIMIT ËSHTË TË KRIJOJË MJEDISE TË QËNDRUESHME QË LIDHIN NJERIUN ME NATYRËN. BIODIVERSITETI PLANETAR ËSHTË MISIONI MË FISNIK I ARKITEKTURËS. URBANIZIMI GLOBAL I MEGA-STRUKTURAVE ËSHTË NË ZGJERIM. PROCESI PËRFESHIN VENDET DHE SHOQËRITË KU 'VENDIMARRJA' KA NJË NDIKIM GLOBAL. MUNGESA E PLANIFIKIMIT TË QËNDRUESHËM E VË TOKËN NË RREZIK. ÇËSHTJA MË E MPREHTË ËSHTË KRIZA E NGROHJES GLOBALE. NA MUNGON NDËRGJEGJËSIMI DHE VEPRIMET E KOORDINUARA PËR TË SHMANGUR EFEKTET E KATASTROFËS KLIMATIKE. ASNJË VEPRIM NJERËZOR NUK MUND TË SHIHET MË SI 'INDIVIDUAL'. ËNDRRAT DHE VIZIONI I PËRJETËSISË EKZISTOJNË NË PËRVOJAT KALIMTARE. TOKA, NATYRA, JANË TË TRANSFORMUESHME. SYNIMET E KUJTESËS SI 'ARKIVI-MOBIL' DUHET TË AKTIVIZOHEN NË BOTËN E NDËRGJEGJSHME SI NJË IDEAL-FANTASTIK.

Urbanizimi i qëndrueshëm duhet të respektojë ekuilibrin e Ekosistemit. Urb— Arkitektura kërkon qasje inovative, ndërtimin e strukturave të shumë—qëndrueshme që e mbrojnë mjedisin. Formësimi i mjedisit i revolucionarizon konceptet sociale, politike dhe hapësinore, forcon lidhjet midis njerëzve dhe vendeve. Aktualisht, megastrukturat nuk garantojnë Qëndrueshmëri. Ka shumë palë të interesuara, me interesa të ndryshëm, që i përcaktojnë pasojat: Qeveritë, qendrat e mëdha financiare, tregtia dhe ekonomia, kompanitë shumëkombëshe... Të gjithë palet kanë pak konsideratë për planifikimin racional dhe përdorimin 'Jo-t'mençur' të burimeve ekzistuese.

Ndërkohë Toka është në një situatë të mjerueshme, e mbingarkuar nga mbeturinat që e bëjnë atë një deponi. Ëndrrat dhe vizioni i përjetësisë Ekzistojnë në hapësirat dhe përvojat kalimtare.

Jeta shoqërore është gjithashtu e mjerueshme me shtëpitë e shndërruara në fabrika, njësitë e riciklimit, shfrytëzimin e punës së fëmijëve, punimet ne ndërtim brenda 24 orësh... Jeta urbane degradon në mosrespektim të QYTETIT si një habitat njerëzor. TOKA, natyra, janë të transformueshme. Kujtesa, ndjekja e synimeve fisnike si 'arkivi—mobil' duhet të aktivizohet në Botën e ndërgjegjshme si një Ideal. Bota—Fantastike e mundësive. Arkitektët dhe planifikuesit duhet, detyrohen ta ringjallin dhe përditësojnë. Në këtë drejtim, përtej individualizmit, kërkohet komunikimi i vazhdueshëm dhe angazhimi i palëkundur.

Kosova për dekada ka qenë një vend që është "zhvilluar" dhe degraduar nga

teknologjia e ndyrë. Ky kapitull duhet të mbyllet dhe zhvillimi i Qëndrueshëm duhet të hapet.

Projekti 'CONTAINER' është një 'objekt' i madh i hapur, i mbyllur, i destinuar për ngarkimin e 'PËRMBAJTJEVE' të ndryshme. Ka formë, funksion dhe dizajn të jashtëzakonshëm. Ndodhet në çdo komunë. Rreth këtij kontejneri mbetet i hapur peizazhi i ndërtesave të ndërtuara për të qenë të përjetshme; Specifikat që ofrojnë 'MUNDËSITË E REJA' të përdorimit, hapësirat për eksperimentimin, socializimin, reflektimin, aktivizimin, shpresën, idetë e reja, fantazitë dhe qëllimet... TERRA EST STELLA.

MAKSUT VEZGISHI

I lindur në Prizren, Kosovë në vitin 1960. Vezgishi u diplomua për Arkitekturë në Universitetin e Prishtinës në 1990. Në Fakultetin e Arkitektures Ai punoi si asistent gjatë periudhës 1993—1996. Njëkohësisht ka punuar si redaktor artistik në revistën politike 'ZËRI' dhe Art—revistat kulturore—mikste në Prishtinë. Në vitin 1990 ka drejtuar 'skenën Alternative' në 'Teatri i Qytetit' në Prizren. Interesimi i Vezgishit në arkitekturë dhe artet vizuale është 'Experimenti/ Modernizmi'. Rrjedhimisht, sjell vëmendjen në 'Kërkimi' në artin—aktual shqiptar. Vezgishi është autor në disa disiplina të artit bashkëkohor. Nga viti 1998/99 jeton dhe punon në Bruksel.

KOMISIONERE

Jehona Shyti
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Republika e Kosovës

KURATOR/ EKSPUZUES

Maksut Vezgishi

ORGANIZON

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Republika e Kosovës

EXPOZUES

Vildane Maliqi
Argjire Krasniqi
Fera Dervis
Recep Kerkezi
Gëzim Radoniqi

MUZIKA

Elvis Bytyqi
Gjulia Bytyqi

DIZAJNI GRAFIK

Nita Salihu Hoxha

FOTOGRAF

Edon Agushi

MBËSHTETUR

Presidenca e Republikës së Kosovës

VENDI

Arsenale

@KOSOVOPAVILION17TH
INFO@KOSOVOPAVILION17TH.COM
KOSOVOPAVILION17TH.COM

